

V E N D I M
Nr.3, datë 7.1.1999

PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT NË FUSHËN E KËRKIM-SHPËTIMIT (SAR) TË AVIONËVE NË RAST AKSIDENTESH AJRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 48 të ligjit nr.7877, datë 30.11.1994 "Për aviacionin civil shqiptar", me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Mbrojtjes e Republikës së shqipërisë është përgjegjëse e politikës së përgjithshme në fushën e kërkim-shpëtimit të avionëve në rrezik dhe të aksidenteve, si dhe për strukturat, organizimin, funksionimin dhe ushtrimin e shërbimit SAR në favor të avionëve civilë dhe ushtarakë, si për ata vendas ashtu dhe të huaj, mbi territorin dhe ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë.

Në atë masë në të cilën lejon ky funksion kryesor, organizimi SAR shqiptar do të ndërhyjë duke ndihmuar dhe shpëtuar në të gjitha situatat në të cilat jeta njerëzore është në rrezik.

2. Shërbimi SAR ka për detyrë:

- të lokalizojë avionët në rrezik dhe të aksidentuar në hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë dhe të drejtojë për në vendin e aksidentit, sa më shpejt që të jetë e mundur, mjetet e nevojshme të shpëtimit;

- të bashkëpunojë në operacionet SAR me shërbimet SAR të vendeve kufitare, me të cilat janë bërë marrëveshje në sektorin e kërkim-shpëtimit;

- të marrë pjesë së bashku me autoritetet kompetente, civile apo ushtarake vendore, në operacionet e ndihmës së personave që ndodhen në rrezik për jetën dhe në operacionet e ndihmës në aksidentet shumë të rënda, katastrofat dhe fatkeqësitë natyrore;

- të sigurojë dhe të drejtojë operacionet e ndihmës komplekse të mjeteve tokësore, ajrore apo detare që përfshihen në këto operacione, duke përcaktuar përparësitë e ndërhyrjeve për këto misione ndihme.

3. Shërbimi i kërkim-shpëtimit përbëhet nga:

- Zyra e Studimeve dhe Koordinimeve SAR të Shtabit të Përgjithshëm;

- Qendra e Koordinim-Shpëtimit (Rescue Coordination Center - RCC);

- Njësia e Kërkim-Shpëtimit (Search Rescue Unit - SRU) ajror, tokësor dhe detar të Forcave të Armatosura Shqiptare.

Strukturat respektive të çdo organike do të vendosen nga Ministria e Mbrojtjes me akte të veçanta nënligjore.

4. Zyra e Studimeve dhe Koordinimeve SAR ka për detyrë:

- të përcaktojë dhe të zbatojë politikën që do të përshkojë organizmi SAR;

- të mbikëqyrë funksionimin dhe veprimet operative të organizmit SAR;

- të përgatisë dhe të shpërndajë, në nivel kombëtar, normat, procedurat dhe direktivat vepruese për funksionimin e shërbimit SAR;

- të mbajë marrëdhënie ndërkombëtare në fushën e SAR-it me shërbimet SAR të vendeve kufitare, me të cilat janë nënshkruar marrëveshje përkatëse;

- të mbajë raporte në fushën SAR me administratën shtetërore, si atë civile dhe atë ushtareake dhe entet private, me të cilat ekzistojnë marrëveshje për operacionet e kërkim-shpëtimit, dhe nëse është e nevojshme të stimulojë marrëveshje të tilla;

- të propozojë zgjidhje që përmirësojnë efektivitetin e veprimtarisë së shërbimit SAR;

- të hartojë dhe të sigurojë standardizimin e stërvitjes dhe përshtatjes së saj me programin përgatitor.

5. RCC (Qendra e Koordinim-Shpëtimi) e aktivizuar në kohë të plotë gjatë gjithë 24-orëshit është përgjegjëse për planifikimin, organizimin, drejtimin, koordinimin dhe kontrollin e operacioneve të kërkim-shpëtimit në rajonin e kërkim-shpëtimit (Search Rescue Region - SRR) të juridiksionit shqiptar.

Për ekzekutimin e operacioneve SAR, RCC-ja angazhon njësitë SAR ajrore, tokësore dhe detare, të Forcave të Armatosura Shqiptare, të administratës shtetërore të enteve shtetërore, që mund të jetë e nevojshme të përfshihen në operacionet e ndihmës.

6. Në ngjarje të tilla si aksidentet ajrore, katastrofat, fatkeqësitë natyrore që kërkojnë një efikasitet shumë të madh në drejtimin dhe koordinimin e mjeteve ajrore në operacionet e ndihmës, mund të aktivizohet eventalisht me vendimin e drejtorit të RCC-së, një vend-komande e koordinimit të avancuar (PCSAR - Comand Post SAR).

7. Administrata shtetërore dhe entet private, komandat e njësive të ushtrisë, forcat e rendit, policia doganore, zjarrfikësit, policia pyjore dhe organe të tjera janë të detyruara të marrin pjesë, nëse kërkohet, në operacionet e kërkim-shpëtimit.

Mënyrat e ndërhyrjes përcaktohen nga protokolle bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe administratave përkatëse.

8. Shpenzimet financiare për ushtrimin e shërbimit SAR përcaktohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me buxhetin e shtetit, të miratuara për Ministrinë e Mbrojtjes.

9. Rajoni i kërkim-shpëtimit kombëtar (SRR - Search Rescue Region) përfshin territorin dhe ujërat territoriale, nën juridiksionin e Republikës së Shqipërisë, të kufizuar nga segmentet koordinative gjeografike:

- kufiri gjeografik;

- rajoni informativ i fluturimit (hapësirë e sipërme) FIR/UIR

402500N 190000E 403554N 190000E (GOKEL) - 404500N 190000E- 405330N 185706E (PAPIZ) - 410800N 185200E -412748N 190600E (RODON) - 413448N-191036E (GLIDA) - 415000N 192200E - kufiri shqiptaro-jugosllav - 420600N 192400E - 421300N 192036E (RETRA) - kufiri shqiptaro-jugosllav - 422900N 195100E (ALELU) - kufiri shqiptaro-jugosllav 415300N 203500E - kufiri shqiptar - ish Republika Jugosllave e Maqedonisë - 414012N 203148E (MAVAR) - 405300N 205900E - kufiri greko-shqiptar - 4 03700N 210300E (GENSU) - 402851N 205731E (PINDO) - kufiri greko-shqiptar - 400353N 203007E (SKERD) - 395854N 202330E (VJOSA) - kufiri greko-shqiptar - 395400N 195042E (PITAS) - 402500N 190000E.

10. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të nxjerrin udhëzimet dhe rregulloret përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko